

# Çfarë po ndodh në Shkollat Publike të qytetit të Nju-Jorkut

Shiko këtë dokument në shqip	عرض هذه الوثيقة باللغة العربية	এই নথিটি বাংলা ভাষায় দেখুন
查看本文件的简体中文版本	查看本文件的繁體字中文版本	Consultez ce document en français
이 문서를 한국어로 보십시오	Документ на русском языке	Gade dokiman sa a an Kreyòl ayisyen
Переглянути цей документ українською мовою	اس دستاویز کو اردو میں ملاحظہ کریں	Consulte este documento en español
		Ushbu hujjatni ichida ko'ring O'zbek

[schools.nyc.gov/MessagesForFamilies](https://schools.nyc.gov/MessagesForFamilies)

## Prill 2026

Ky përditësim për familjet ofron informacion për ofertat e Programit Veror (Summer Rising), përditësimet e pranimeve, Anketën e Shkollave të NYC-së, një asistent të ri të automatizuar gjuhësor, si dhe aktivitetet e muajit prill.

### Përmbajtja

- [Ofertat për Programin Veror \(Summer Rising\) për Vitin 2026](#)
- [Data të Rëndësishme të Pranimeve](#)
- [Anketa e Shkollave të NYC për Vitin 2026](#)
- [Asistenti i Automatizuar Gjuhësor](#)
- [Aktivitetet dhe Përkujtesit për Muajin Shkurt](#)

### Rezultatet e Programit Veror (Summer Rising)

Duke filluar nga dita e **martë, 21 prill**, familjet që kanë dorëzuar aplikimet për [Programin Veror \(Summer Rising\)](#) brenda afatit të 27 marsit mund të hyjnë në [MySchools.nyc](#) për të parë rezultatet. Vendet në [Programin Veror \(Summer Rising\)](#) janë të kufizuara—ju lutemi ta pranoni ofertën vetëm nëse fëmija juaj do të marrë pjesë në pjesën më të madhe të programit të planifikuar. Studimet tregojnë se sa më shumë të marrin pjesë nxënësit, aq më mirë përgatiten për të pasur sukses në matematikë dhe lexim në vjeshtë.

**Afati i fundit për të pranuar ose refuzuar ofertat për Programin Veror (Summer Rising) është dita e martë, 5 maj**—nëse pranoni, sigurohuni që të plotësoni çdo pyetje të kërkuar për të garantuar vendin e fëmijës suaj! Vendet në këtë program nuk do të konfirmohen nëse familjet nuk e pranojnë ofertën brenda afatit; **fëmija juaj nuk do të regjistrohet automatikisht**. Pranimi i një oferte nuk ndikon në mundësinë që fëmija juaj të marrë një ofertë nga lista e pritjes në një datë të mëvonshme.

### Data të Rëndësishme të Pranimeve

**Aplikimi në Programet për Nxënësit me Aftësi të Veçanta dhe të Talentuar (G&T) për klasat e larta hapet më 20 prill**

Programet për Nxënësit me Aftësi të Veçanta dhe të Talentuar (G&T) ofrojnë mësimdhënie të përsheptuar për nxënësit e kualifikuar të shkollës fillore në qytet. Nëse fëmija juaj do të jetë në klasën 1, 2, 3 ose 4 gjatë vitit shkollor 2026–27 dhe plotëson kërkesat e notave në dëftesë, ai mund të aplikojë për pranimet e vjeshtës së vitit 2026 për G&T, përmes [MySchools.nyc](#). Familjet e nxënësve të kualifikuar do të marrin një email dhe/ose një letër me postë që i fton të aplikojnë për G&T. Aplikimet mbyllen **të premten, më 8 maj**. Mësoni më shumë në [schools.nyc.gov/GT](#) dhe verifikoni informacionet tuaja të kontaktit në [MySchools.nyc](#).

## Ofertat për Kopsht dhe Shkollë të Mesme të Ulët

- Nëse keni aplikuar për kopsht për vjeshtën 2026 brenda afatit të 23 janarit 2026, do ta merrni ofertën e fëmijës suaj më **31 mars 2026**. Familjet duhet ta pranojnë ofertën deri më 1 maj për të siguruar vendin.
- Nëse keni aplikuar për shkollë të mesme të ulët për vjeshtën 2026 brenda afatit të 12 dhjetorit 2025, do ta merrni ofertën e fëmijës suaj më **15 prill 2026**.

Do të merrni një email me informacion për hapat e mëtejshëm sapo oferta dhe çdo listë pritjeje ku është përfshirë fëmija juaj (nëse ka) të jenë të disponueshme në [MySchools](#). Vizitoni [schools.nyc.gov/MS](#) dhe [schools.gov/K](#) për informacion se si bëhen ofertat.

## Anketa e Shkollave të NYC për Vitin 2026

Afati për plotësimin e [Anketës së Shkollave të NYC-së](#) është shtyrë deri më **17 prill 2026**! Familjet e NYCPS-së dhe nxënësit nga klasa 6-12 mund të ndajnë mendime të drejtpërdrejta dhe konfidenciale që na ndihmojnë të përmirësojmë shkollat për vitin e ardhshëm dhe më tej. Plotësoni anketën sot, me postë ose në internet, në një nga 13 gjuhët e disponueshme në [NYCSchoolSurvey.org](#).

## Asistenti i Ri i Automatizuar Gjuhësor

Komunikimi me shkollën e fëmijës suaj është bërë më i lehtë! Të gjithë punonjësit e NYCPS-së tani kanë akses në Hello!, një mjet dixhital që mbështet përkthimin dhe interpretimin automatik në kohë reale gjatë komunikimeve të përditshme, në gjuhët më të përdorura joanglisht nga familjet e NYCPS-së. Hello! nuk zëvendëson përkthimin zyrtar të komunikimeve të rëndësishme apo interpretimin në takime të planifikuara; për këto shërbime, ju lutemi kontaktoni shkollën tuaj.

## Aktivitetet dhe Përkujtuesit për Muajin Shkurt

- Në datat **2-10 prill 2026**, shkollat do të jenë të mbyllura për pushimet e pranverës.
- Dita e ardhshme e Veprimit për Klimën është **më 22 prill**! Burime dhe aktivitete mund të gjenden në [schools.nyc.gov/ClimateAction](#).
- Orari i testeve shtetërore të NY për prillin dhe majin është i disponueshëm në [schools.nyc.gov/TestCalendar](#).